



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Vendosi: Trupi Gjykues II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Bart

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 21 shtator 2023

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Kërkesën e Selimit për një Version me më pak Redaktime të
Vendimit mbi Konfirmimin e Aktakuzës**

**Ushtruesit të Detyrës së
Zëvendësprokurorit të Specializuar
Vard Ferdinandse**

**Mbrojtësit të Viktimave
Sajmon Loz**

**Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Gregori Kihou**

**Mbrojtjes së Kadri Veselit
Ben Emerson**

**Mbrojtësit të Rexhep Selimit
Xhefri Roberts**

**Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda**

TRUPI GJYKUES II i Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Trupi Gjykues”), në pajtim me nenin 21(2) dhe (4), 23, 40(2) dhe (6)(f) dhe (h) të Ligjit Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, si dhe rregullave 80, 81 dhe 82(5) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës, lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 26 tetor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi aktakuzën fillestare kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit (“Vendimi i Parë i Konfirmimit”).¹
2. Më 22 prill 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi ndryshimet e aktakuzës fillestare të konfirmuar (“Vendimi i Dytë i Konfirmimit”).²
3. Më 27 janar 2023, në pajtim me vendimin e Trupit Gjykues (“Vendimi mbi Redaktimet në Aktakuzë”),³ versioni rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* i aktakuzës së konfirmuar me disa ndryshime të mëtejshme (“Aktakuza”)⁴ u riklasifikua si konfidencial dhe iu hoq statusi *ex parte*.⁵

¹ F00026, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit*, 26 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar konfidencial u lëshua më 19 nëntor 2020, F00026/CONF/RED. Versioni i redaktuar publik u lëshua më 30 nëntor 2020, F00026/RED.

² F00777, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Ndryshimeve në Aktakuzë*, 22 prill 2022, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar publik (F00777/RED) dhe një version i redaktuar konfidencial (me më pak redakte) (F00777/CONF/RED2) u lëshuan përkatësisht më 6 dhe 16 maj 2022.

³ F01229, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Redaktimet të Aktakuzës*, 26 janar 2023, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 40(a). Versioni i redaktuar konfidencial u dorëzua më 27 janar 2023, F01229/CONF/RED.

⁴ F00999/A01, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 1 e Parashtrimit të Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar*, 30 shtator 2022, konfidenciale.

⁵ F01239, Zyra Administrative (Njësia për Administrimin e Gjykatës), *Memorandum në Përputhje me Versionin e Redaktuar Konfidencial të Vendimit mbi Redaktimet të Aktakuzës*, F1229, 30 janar 2023, konfidencial.

4. Më 15 shkurt 2023, në pajtim me Vendimin mbi Redaktime të Aktakuzës,⁶ Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) dorëzoi një version konfidencial me më pak redaktime të dosjes së saj.⁷
5. Më 6 mars 2023, Mbrojtja e Rexhep Selimit (“Mbrojtja e Selimit”) dorëzoi një kërkesë për një version më pak të redaktuar të Vendimit të Parë të Konfirmimit (“Kërkesa e Selimit”).⁸
6. Më 17 mars 2023, ZPS-ja ktheu përgjigje ndaj Kërkesës së Selimit (“Përgjigja e ZPS-së”).⁹
7. Më 24 mars 2023, ZPS-ja e njoftoi Trupin Gjykses për synimin e saj për heqjen e redaktimeve jostandarde që mbrojnë identitetet e disa dëshmitarëve (“Njoftimi i ZPS-së”).¹⁰
8. Më 18 prill 2023, Trupi Gjykses lëshoi një vendim mbi një kërkesë të ZPS-së për ndryshimin e masave mbrojtëse në fuqi për dy dëshmitarë (“Vendimi i 18 prillit 2023”), ku: (i) ndryshoi masat mbrojtëse në fuqi për një dëshmitar (“dëshmitari 1”) për të lejuar heqjen e redaktimeve jostandarde në materialet e dëshmitarit dhe la në fuqi masat mbrojtëse për dëshmitarin tjetër; dhe (ii) urdhëroi ZPS-në që të nxirrte materialin e dëshmitarit 1 pa redaktime jostandarde për Mbrojtjen jo më vonë se 25 prill 2023.¹¹

⁶ Vendimi mbi Redaktime të Aktakuzës, para. 40(b).

⁷ F01296/A01, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 1 e Parashtrimeve të Prokurorisë në përputhje me Vendimin F01229, Versioni me më pak Redaktime i Versionit të Redaktuar Konfidencial të Versionit të Korrigjuar të Dosjes Paraprake të Prokurorisë, KSC-BC-2020-06/F00709, i datës 24 shkurt 2022, 15 shkurt 2023, konfidencial.*

⁸ F01347/COR, Mbrojtësi i Specializuar, *Versioni i Korrigjuar i Kërkesës së Mbrojtjes së Selimit për një Version me më pak Redaktime të Vendimit të Konfirmimit të Aktakuzës, 7 mars 2023 (kërkesa origjinale u dorëzua më 6 mars 2023), me Shtojcën 1.*

⁹ F01384, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Mbrojtjes së Selimit për Vendimin me më pak Redaktime të Konfirmimit, 17 mars 2023, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe ex parte.*

¹⁰ F01394, Prokurori i Specializuar, *Njoftim për Nxjerrjen e Vonuar të Identiteteve të Dëshmitarëve, 24 mars 2023, konfidencial, veçanërisht para. 1.*

¹¹ F01466, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e ZPS-së për Ndryshimin e Masave Mbrojtëse, 18 prill 2023, konfidencial, para. 17(b)-(d).*

9. Më 9 qershor 2023, ZPS-ja dorëzoi një version konfidencial me më pak redaktime të dosjes së saj paraprake.¹²

10. Më 12 shtator 2023, në pajtim me udhëzimet e Trupit Gjykses,¹³ ZPS-ja dorëzoi një parashtrim plotësues të Përgjigjes së ZPS-së (“Parashtrimi Plotësues i ZPS-së”).¹⁴

II. PARASHTRIME

11. Mbrojtja e Selimit i kërkon Trupit Gjykses të lëshojë një version konfidencial me më pak redaktime të Vendimit të Parë të Konfirmimit për të pasqyruar versionet me më pak redaktime të Aktakuzës dhe dosjes paraprake të ZPS-së.¹⁵ Ajo argumenton veçanërisht edhe se: (i) për shkak të heqjes së të gjitha redaktimeve në Aktakuzë për Mbrojtjen, redaktimet përkatëse në Vendimin e Parë të Konfirmimit nuk janë më të domosdoshme ose të arsyeshme;¹⁶ dhe (ii) marrja e informacionit që përmban Vendimi i Parë i Konfirmimit në lidhje me pretendimet e paredaktuara së fundmi kundër Rexhep Selimit në Aktakuzë do të ndihmonte Mbrojtjen e Selimit për t’u përgatitur në lidhje me këto pretendime.¹⁷ Gjithashtu Mbrojtja e Selimit pretendon se një version me më pak redaktime është i përligjur pasi Vendimi i Parë i Konfirmimit është një “instrument pas nxjerrjes së akuzës” që peshon akuzat që përmban Aktakuza kundrejt standardit të argumentit të bazuar.¹⁸

¹² F01594/A03, Prokurori i Specializuar, *Versioni me më pak Redaktime i Versionit të Redaktuar Konfidencial të Versionit të Korrigjuar të Dosjes Paraprake të Prokurorisë*, 9 qershor 2023, konfidencial.

¹³ CRSPD309, *Mesazh Elektronik i Trupit Gjykses II drejtuar NJAGJ-së me Udhëzime për ZPS-në për Parashtrimet e Mëtejshme në lidhje me Kërkesën e Selimit F01347*, 5 shtator 2023, konfidencial.

¹⁴ F01783, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim Plotësues i Prokurorisë për Parashtrimin e Protokolluar F01384*, 12 shtator 2023, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

¹⁵ Kërkesa e Selimit, para. 1 dhe poshtëshënimi 2. *Shih gjithashtu Kërkesën e Selimit*, para. 6.

¹⁶ Kërkesa e Selimit, para. 3.

¹⁷ Kërkesa e Selimit, para. 4.

¹⁸ Kërkesa e Selimit, para. 5, *që i referohet Vendimit mbi Redaktime të Aktakuzës*, para. 17.

12. Mbrojtja e Selimit pranon se versioni plotësisht i paredaktuar i Vendimit të Parë të Konfirmimit nuk mund t'i vihet në dispozicion Mbrojtjes për shkak të disa masave mbrojtëse ende në fuqi. Rrjedhimisht, ajo kërkon vetëm dorëzimin e një versioni me më pak redaktime.¹⁹

13. ZPS-ja parashtron se, në parim, nuk e kundërshton Kërkesën e Selimit, por disa redaktime vazhdojnë të jenë të domosdoshme për zbatimin e masave mbrojtëse në fuqi për disa dëshmitarë.²⁰ Gjithashtu ZPS-ja bën të ditur se: (i) po kryen një rishikim të domosdoshmërisë për masa mbrojtëse; (ii) një kërkesë e ZPS-së për ndryshimin e masave mbrojtëse për dy dëshmitarë është në shqyrtim para Trupit Gjyqës; dhe (iii) rrjedhimisht, Kërkesa e Selimit mund të jetë e parakohshme.²¹ Megjithatë, sa i përket kohës së përshtatshme për çfarëdo versioni konfidencial më pak të redaktuar të Vendimit të Parë të Konfirmimit, ZPS-ja ia lë Trupit Gjyqës të vendosë, me kusht që të mbahen redaktimet e domosdoshme në zbatim të masave mbrojtëse ekzistuese.²²

14. ZPS-ja parashtron në parashtrimin e saj plotësues se disa nga redaktimet që kishte identifikuar në Shtojcën 1 të Përgjigjes së ZPS-së ("Shtojca 1") si redaktime që vazhdojnë të jenë të domosdoshme, nuk janë më të domosdoshme në këtë fazë pasi identitetet e dëshmitarëve përkatës i janë zbuluar Mbrojtjes.²³ Megjithatë, ZPS-ja parashtron se disa numra shtesë të regjistrimit të provave ("ERN") të transkripteve që nuk janë përmendur më herët në Shtojcën 1 duhet të mbahen të redaktuara.²⁴

¹⁹ Kërkesa e Selimit, poshtëshënimi 2.

²⁰ Përgjigja e ZPS-së, para. 1 dhe poshtëshënimi 3, që i referohet Shtojcës 1 të Përgjigjes së ZPS-së.

²¹ Përgjigja e ZPS-së, para. 2 dhe poshtëshënimet 4-6.

²² Përgjigja e ZPS-së, para. 2.

²³ Parashtrimi i ZPS-së, para. 2, që i referohet redaktimeve që përmenden në rreshtin e parë dhe të katërt të Shtojcës 1.

²⁴ Parashtrimi i ZPS-së, para. 3-4.

III. DISKUTIM

15. Trupi Gjykses rikujton se Vendimi i Parë fillestar i Konfirmimit u lëshua nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake vetëm në një version rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*. Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi më pas një version konfidencial me redaktime të bazuara në redaktimet e aktakuzës të dorëzuar nga ZPS-ja. Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake autorizoi shtyrjen e nxjerrjes së informacionit për Mbrojtjen në lidhje me disa dëshmitarë të ZPS-së ose 30 ditë para fillimit të gjykimit, ose 30 ditë para dhënies së dëshmimeve.²⁵ Sipas vlerësimit të

²⁵ P.sh. F00133/COR, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Versioni i Korrigjuar i Vendimit të Parë mbi Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Masa Mbrojtëse*, 14 dhjetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* (një version i redaktuar konfidencial u lëshua të njëjtën ditë, F00133/COR/CONF/RED); F00190, *Vendim mbi Kërkesën e Dytë të Prokurorit të Specializuar për Masa Mbrojtëse dhe Kërkesën e Përsëritur për Masa Mbrojtëse dhe Çështje Procedurale*, 5 shkurt 2021, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* (një version i redaktuar konfidencial u lëshua të njëjtën ditë, F00190/CONF/RED); F00211, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendimi i Tretë mbi Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Masa Mbrojtëse*, 3 mars 2021, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* (një version i redaktuar konfidencial u lëshua të njëjtën ditë, F00211/CONF/RED); F00239, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendimi i Katërt mbi Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Masa Mbrojtëse*, 26 mars 2021, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* (një version i redaktuar konfidencial u lëshua të njëjtën ditë, F00239/CONF/RED); F00338, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendimi i Pestë mbi Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Masa Mbrojtëse*, 4 qershor 2021, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* (një version i redaktuar konfidencial u lëshua më 7 qershor 2021, F00338/CONF/RED); F00373, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendimi i Gjashtë mbi Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Masa Mbrojtëse*, 25 qershor 2023, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* (një version i redaktuar konfidencial u lëshua të njëjtën ditë, F00373/CONF/RED); F00407, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendimi i Shtatë mbi Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Masa Mbrojtëse*, 21 korrik 2021, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* (një version i redaktuar konfidencial u lëshua të njëjtën ditë, F00407/CONF/RED); F00438, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendimi i Tetë mbi Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Masa Mbrojtëse*, 24 gusht 2021, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* (një version i redaktuar konfidencial u lëshua të njëjtën ditë, F00438/CONF/RED); F00466, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendimi i Nëntë mbi Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Masa Mbrojtëse*, 13 shtator 2021, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* (një version i redaktuar konfidencial u lëshua të njëjtën ditë, F00466/CONF/RED); F00467, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendimi i Dhjetë mbi Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Masa Mbrojtëse*, 13 shtator 2021, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* (një version i redaktuar konfidencial u lëshua të njëjtën ditë, F00467/CONF/RED); F00559, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendimi i Njëmbëdhjetë mbi Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Masa Mbrojtëse*, 5 nëntor 2021, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* (një version i redaktuar konfidencial u lëshua më 17 dhjetor 2021, F00559/CONF/RED); F00571, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendimi i Dymbëdhjetë mbi Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Masa Mbrojtëse*, 17 nëntor 2021, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* (një version i redaktuar konfidencial u lëshua të njëjtën ditë, F00571/CONF/RED); F01057, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Parashtrimin e Prokurorisë sipas Rregullës 102(2) dhe Kërkesat lidhur me Të*, 27 tetor 2022, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* (një version i redaktuar konfidencial u lëshua të njëjtën ditë, F01057/CONF/RED); F01058, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Shtimin e Dy Dëshmitarëve dhe Materialeve*

Gjykatësit të Procedurës Paraprake, shtyrja e nxjerrjes së identiteteve ishte e justifikuar në secilin rast për shkak të një rreziku objektiv.

16. Pas shqyrtimit të redaktimeve në Vendimin e Parë të Konfirmimit, Trupi Gjykes gjykon se shumica dërrmuese e këtyre redaktimeve nuk janë më të domosdoshme në versionin konfidencial të vendimit në këtë fazë të procesit, veçanërisht duke pasur parasysh: (i) heqjen e të gjitha redaktimeve në Aktakuzë për Mbrojtjen më 27 janar 2023; (ii) nxjerrjen pa redaktime për Mbrojtjen, të një sasive të madhe materialesh në lidhje me dëshmitarin më 30 janar 2023; dhe (iii) nxjerrjen e mëtejshme pa redaktime jostandarde të materialeve që kanë të bëjnë me dëshmitarin në prill 2023.²⁶ Duke pasur parasysh hapjen e gjykimit më 3 prill 2023 dhe në pajtim veçanërisht me nenet 21(4), 40(2) dhe rregullën 82(5), Trupi Gjykes e konsideron të përshtatshëm lëshimin e një versioni konfidencial me më pak redaktime të Vendimit të Parë të Konfirmimit në këtë fazë të procesit.

17. Trupi Gjykes pajtohet me ZPS-në se redaktimet e përmendura në rreshtin e parë dhe të katërt të Shtojcës 1 nuk janë më të domosdoshme pasi identitetet e dëshmitarëve përkatës i janë nxjerrë tashmë Mbrojtjes.²⁷ Sa u përket redaktimeve të përmendura në rreshtin e dytë të Shtojcës 1, Trupi Gjykes gjykon se duke pasur parasysh Vendimin e 18 prillit 2023,²⁸ këto redaktime duhet të mbeten në fuqi në zbatim të masave mbrojtëse ekzistuese për dëshmitarët përkatës. Po kështu, redaktimet e përmendura në rreshtin e tretë të Shtojcës 1 mbeten të domosdoshme për zbatimin e masave mbrojtëse në fuqi për dëshmitarin përkatës. Sa u përket ERN-ve të përmendura në Parashtrimin Plotësues të ZPS-së, Trupi Gjykes pajtohet se këto redaktime mbeten të domosdoshme për mosnxjerrjen e informacionit të mbrojtur. Gjithashtu, Trupi Gjykes gjykon se është e nevojshme

lidhur me Ta, 27 tetor 2022, rreptësisht konfidencial dhe ex parte (një version i redaktuar konfidencial u lëshua të njëjtën ditë, F01058/CONF/RED).

²⁶ Veçanërisht sa u përket dëshmitarëve të përmendur në Njoftimin e ZPS-së.

²⁷ *Shih veçanërisht* Vendimin e 18 prillit 2023, para. 17(b) dhe (d); Paketat 739-741 të Materialet e Nxjerra, 764.

²⁸ Vendimi i 18 prillit 2023, para. 17(c).

të mbahen edhe disa redaktime të tjera për të mos rrezikuar masat mbrojtëse ekzistuese për disa dëshmitarë anonimë ose dëshmitarë për të cilët shtyhet nxjerrja e identitetit.

18. Për të njëjtat arsye të përmendura në paragrafin 16 më lart, Trupi Gjykes e gjykon të përshtatshme që të lëshojë *proprio motu* edhe një version konfidencial me më pak redaktime të Vendimit të Dytë të Konfirmimit. Pas shqyrtimit të redaktimeve në atë vendim, Trupi Gjykes gjykon se mbeten vetëm disa redaktime të domosdoshme në zbatim të masave mbrojtëse ekzistuese.

19. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykes miraton Kërkesën e Selimit për aq sa ajo nuk bie ndesh me cilëndo prej masave mbrojtëse që mbeten në fuqi.²⁹ Trupi Gjykes do të lëshojë disa versione konfidenciale me më pak redaktime të Vendimit të Parë të Konfirmimit dhe Vendimit të Dytë të Konfirmimit.

20. Trupi Gjykes do të paraqesë versionet publike me më pak redaktime të Vendimit të Parë të Konfirmimit dhe Vendimit të Dytë të Konfirmimit në kohën e duhur.

IV. KLASIFIKIMI

21. Duke vënë në dukje se ZPS-ja propozon të dorëzojë një version konfidencial të redaktuar të Parashtrimit Plotësues të ZPS-së, Trupi Gjykes e urdhëron ZPS-në ta dorëzojë atë version deri të **enjten, 28 shtator 2023**.

V. VENDIM

22. Për arsyet e përmendura më lart, Trupi Gjykes:

(a) **MIRATON** Kërkesën;

²⁹ *Shih* më sipër, para. 17.

- (b) **LËSHON** një version konfidencial me më pak redaktime të Vendimit të Parë të Konfirmimit dhe të Vendimit të Dytë të Konfirmimit; dhe
- (c) **URDHËRON** ZPS-në të dorëzojë një version konfidencial të redaktuar të Parashtrimit Plotësues të ZPS-së deri të **enjten, 28 shtator 2023**.

/nënshkrimi/

Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E enjte, 21 shtator 2023

Në Hagë, Holandë.